

## KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

### 613-25-5004-2-1-1/C1107

Kuvendi Komunal Lipjan të cilën e përfaqëson, **Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit në Lipjan z. Bekim Shabani** në njérën anë (në tekstin e mëtejmë) Autoriteti Kontraktues; dhe

"Company Zuka Commerce" Sh.p.k., Metush Krasniqi nr.135, GJILAN, (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për Shërbimet në vijim:

**Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror 6 Llote me numër identifikues: 613-25-5004-2-1-1**

#### Neni 1              Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim: **Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror Kleqk[ dhe Divjak, llojt, sipas kesaj kontrate dhe paramasës e cila është pjesë përbërëse e kësaj kontrate.**

**a) Largimi I Borës nga rruga:**

**b) Hedhja e krypës të kombinuar me rërë :**

Largimi i borës nga rruga duhet të bëhet në mënyr të vazhdushme 24<sup>h</sup>:

Për qdo ditë të reshjeve të borës varsishtë nga koha kur fillojnë , fillimi i punës duhet të jetë i menjëherës pas fillimit të reshjeve.

Nese ato janë të panderprera largimi I borës dhe akullit duhet të bëhet pa nederprerë, ku të gjitha rrugët duhet të jenë të pastruara, para kohës kur fillon fluksi i para kohes kur fillon fluksi i automjeteve (ora 7 e mengjesit)

**Vrejtje:** Në rastë të mos largimit të borës dhe akullit nga rrugët , kompanisë do t'i minusohet shuma për pastrimin e atyre rrugëve në bazë ditore bazë ditore.

Në rastë kur kompania pranon vërejtjen, vazhdon mosperfilljen e respektimit të marrëveshtjes atëhere kompanisë do t'i shkputet kontrata .

Kur kompanija ka defekte në makineri kompania duhet të lajmroj me shkrim organin mbikqyrës ose me email dhe duhet të caktoj Kohën kur mund kohen kur mundet të filloj me sherbime:

Në rastë kur mekanizmi nuk mund të rregullohet mbrenda ditës, operatori është i obliguar të huazoj apo të marrë makineri me qera per perfundimin esherbimeve te kontratuara, ne te kunderten operatori do te shpallet papergjegjeshem

Hedhja e krypës e kombinuar me rërë duhet të bëhet kur temperaturat nuk arrijnë -6° C në rastë se temperaturat kapin vlerat më të ulëta duhet të perdoret makineria (Greder) per gryerjen e bores dhe akullit nga rruga: Kontraktuesit do t'i bëhet pagesa vetem per sherbimet e kryera, kur rruget konstatohen se janë të pastruara nga Bora dhe akulli dhe qdo intervenim te hedhjes se krypes dhe rëres , ndersa per rruget te cilat nuk jan te pastruara mbrenda 24<sup>h</sup> pas reshjeve nuk do te paguhen, si dhe do te minusohen me penalti 10 € per Km qdo ditë te papastruar.

**Kompanija duhet të ketë kujdestari 24<sup>h</sup> gjatë sezonit dimërorë:**

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek Ofruesi i sherbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 15 nëntor 2025 dhe përfundon në datën 15 prill 2027

#### Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë 1 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë;

Nr	Pershkrimi i rrugëve	Gjatësi (m')	Gjersi (m)	siperfaqja-me asfalt m <sup>2</sup>	Sasia e hudhjes se kripes kg/m <sup>2</sup>	Ditet e planifikuara me reshje per hedhje te krypes	Sasia e hudhjes se kripes kg/m <sup>2</sup> për një herë	Sasia e hudhjes se kripes kg/m <sup>2</sup> per 30 herë
1	Kleqkë	6000	4	24000	0.02	30	480	14400
2	Divjakë	2500	3	7500	0.02	30	150	4500
	<b>T O T A L I</b>	<b>8,500</b>		<b>31,500</b>			<b>630</b>	<b>18,900</b>

#### Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës është **23,698.00** Euro. Devijimi i lejuar nga vlera totale indikative është [+30%].

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të janë fiksë dhe nuk do ti nënshtronen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqanta të Kontratës.

#### Neni 4 Rendi i përparsisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;

- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartesisë ose divergencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparsisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvëç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet Shqipe në tri origjinalë, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Bekim Shabani	Emri:	<i>M. Hoxha Rruste</i>
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	<i>Ofizore</i>
Nënshkrimi:	<i>F. Shabani</i>	Nënshkrimi:	<i>Hoxha</i>
Data:	04.09.2025	Data:	09.09.2025
Vula:		Vula:	



## KUSHTET E PËRGJITHSHME

### Neni 1           Përkufizimet

1.1 “**Kontratë**” do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 “**Shërbimet**” do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofruesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përskrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 “**Ofrues i shërbimeve**” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 “**Personeli**” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 “**Çmimi i kontratës**” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 “**Nënkontraktuesi**” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 “**Palë**” nënkuption Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “**Palët**” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 “**Autoriteti Kontraktues**” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 “**KPK**” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “**KVK**” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

### Neni 2           Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

### Neni 3           Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvëç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvëç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

#### **Neni 4 Nën-kontraktimi**

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofrcuesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Ofrcuesi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofrcuesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofrcuesi i Shërbimeve nuk nënkontrakton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofrcuesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofrcuesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofrcuesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

#### **Neni 5 Tatimi**

5.1 Ofrcuesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit te shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shikak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofrcuesi i Shërbimeve.

#### **Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve**

6.1 Ofrcuesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofrcuesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimitari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofrcuesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktivitetave.

#### **Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit**

7.1 Ofrcuesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëren nga këto arsy:

- dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- forcë madhore sic përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofrcuesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvèçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofrcuesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjtë pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

#### Neni 8                  **Forca Madhore**

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tillë parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrrëgullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërvshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paftësinë e një pale të tillë që të përbush dyerimet e saj tanë e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i dyeruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrëthanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrëthanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mijetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mijete të tillë alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

#### Neni 9                  **Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues**

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngashme e paraparë në legislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjyktimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur faktor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofrofresi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofrofresit të Shërbimeve, përvëç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofrofresi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofrofresit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofrofresit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofrofresin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofrofresit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofrofresit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofrofresi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofrofresin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofrofresi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofrofresin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofrofresit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpërt kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofrofresi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

#### **Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofrofresi i Shërbimeve**

10.1 Ofrofresi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofrofresit të Shërbimeve shumat që duhet t'i paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimesh nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofrofresi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofrofresit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofrofresin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofrofresit të Shërbimeve.

#### **Neni 11 Obligimet e Ofrofresit të Shërbimeve**

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofrofresi i Shërbimeve duhet t'i pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofrofresi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai,

duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të batojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të janë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përm bushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbëria e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuara në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkese me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

## Neni 12            Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të janë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tillë duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

## Neni 13            Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i sherbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha sherbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së sherbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit te Sherbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit te Sherbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit sherbime parandalon përdorimin e zakonshëm të sherbimeve në törësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Sherbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të sherbimeve. Ofruesi i sherbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë

koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

*b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofriuesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofriuesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

*c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetet e tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofriuesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofriuesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

*a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetet e tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofriuesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofriuesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

**Neni 14      Siguria e Ekzekutimit**

14.1 Ofriuesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofriuesit të Shërbimeve.

14.2 Garacioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

**Neni 15      Sigurimi që do të merret nga Ofriuesi i Shërbimit**

15.1 Ofriuesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofriuesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

**Neni 16      Parimet të përgjithshme të pagesave**

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofriuesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofriuesi

i Shërbimeve. I njëjtë formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofri i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofri i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i jasin të drejtë Ofri i Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofri i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tillë. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

#### **Neni 17                    Kualiteti i Kontrollit**

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të janë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç eshte definuar në KVK.

#### **Neni 18                    Përmirësimi i Defekteve**

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektit të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofri i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofri i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofri i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim përmes Ekzekutimi që llogaritet siç përshtruhet në nenin 13.1.

#### **Neni 19                    Konsekuençat e Shkeljes se kontratës**

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërbime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### **Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekte për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkесës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkесës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidheje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkësave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiken të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### **Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

#### **Neni 22 Dëmshpërbimi**

22.1 Ofruesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërbilej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

## KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shenimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante.]*


Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshtrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridikzioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Fillimi dhe i Përfundimi shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është <b>15.11.2025-15.04.2026, dhe sezona e dyte: 15.11.2026-15.04.2027</b>
	6.4	Data e Përfundimit është <b>15.04.2027</b>
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është : <i>sipas paramasës dhe KPK</i>
Obligim kontraktuesit	I	<b>Kontraktuesi eshte i obliguar ne momentin e nenshkrimit te kontrates se paku 1/3 e sasise se krypes ta kete te siguruuar ne depo.</b>
inspektimi	7.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të janë si në vijim: Kontrollimi i shërbimeve do të kryhet nga momenti i fillimit të reshjeve, kontrolli do të kryhet edhe nga inspektoret e trafikut dhe Policia e Kosovës dhe qdo vërejtje që jepet nga këto instucionë do të merren parasysh.
penalet	8.1	Kontraktuesi duhet të intervenoj për largimin e borës pas fillimit te reshurave ku trashësia e bores arrin 3 cm, Kur konstatohen se rrugët janë te pastruara nga bora dhe akulli 24 orë pas ndërprerjes së të reshurave dhe është pengesë përlëvizjen e lirë të qytetarëve dhe automjeteve do të ekzekutohen penalet prej 10€ për çdo km të pa pastruar për çdo ditë sa janë rrugët e pa pastruara.
Obligimet Autoritetit Kontraktues	e	Menaxheri i Projektit caktohet Besart Zejnullahu, ndersa MDMK Enver Elshani.
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është <b>0.2%</b> në ditë.  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është <b>[10% e Çmimit të Kontratës]</b> të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: 10% e vlerës së kontratës apo shprehur nominalisht, 2.369.80€, për periudhën kohore 30 muaj.
Sigurimi që do të	15.1	(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me

merret nga ofruesi i shërbimeve		<p>punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, përfunduar sipas 38 te KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përherëshme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkuesave të menaxherit te kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë;</p> <p>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjafthueshme përfunduar në zëvendësimin e tyre;</p> <p>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialete dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 5.000 euro përfunduar, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</p> <p>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>e punëtorëve të Kontraktuesit: 20000 euro përfunduar, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</li> <li>a) e personave të tjera: 20000 euro përfunduar, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</li> </ul>
Parimet përgjithshme pagesës e të	16.1	Orari i pagesës do të jetë: Orari i pagesës do të jetë: Pagesa do të kryhet në fund të sezonit dmth do të kemi vetëm dy pagesa , pagesa e parë do të kryhet në fund te sezonit 2025-2026 , pagesa e dytë në fund të sezonit 2026-2027. Për shumën e kontraktuar nëse ka penale , menaxheri i kontratës do t'i llogarit dhe do të zbret faturën përvleren e penaleve që i konstaton menaxheri i kontratës
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: Kontrollimi i shërbimeve do të kryhet nga momenti i fillimit të reshjeve, kontrolla do të kryhet edhe nga inspektoret e trafikut dhe Policia e Kosovës dhe çdo vërejtje që ipet nga këto instucionë do të merren parasysh
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<b>Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave</b>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë <b>në pajtim me ligjin në Kosovë</b></p> <p>ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përherëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin përmënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi</p>

Mjekësia e dhëna pastrimi i rrugave rurale për dy seazona dimërore 2024/2026 dhe 2026/2027 pjesa per vendimtarët ndërkombëtarë							
Aktivitet							
Poz.	Perdhëni	Njësie	Basha	çmimi njësi	Çmimi për 1 (një) kertë e hundja e kripes per (m <sup>2</sup> )	Shërbimet Sezonale	Shuma përgjithshme për Sezonë
1	Largimi i borës nga mugët sipas spesifikacioneve të paraparë me aktivitete, a) largimi i borës nga mugët b) hedhi e kripes Vrijje: me këtë pozicion duhet të jetet çmimi per m <sup>2</sup> për të gjitha mugët e paraparë sipas spesifikimeve per mimbajtjen e një m <sup>2</sup> të mugës, për largimin e borës që hundjan e kripes në ditët kur ka të reshish.	m <sup>2</sup>	31,600.00	0.0070	220.5000	30.00	6,615.00
Shuma e përgjithshme tabela 1							6,615.00

Poz.	Perdhëni	Njësie	Basha	çmimi njësi	Shuma
2	Furnizimi dhe depozimi i kripis me filmin e sezonit dimëror, meja e easiasë para organit mbikoyres rë deponi, që pagesa kripës do të bëhet përsëllë e shpenzuar sipas pozicionit nr 1	kg	10,900.00	0.0600	1,134.00
Shuma e përgjithshme tabela 2					1,134.00

	Perdhëni	Njësie	Basha	çmimi per një sezon	Shuma
3	Kompania duhet tă caktoj Çmimin përkujdestari gjatë sezonit dimorë 2023/2025-vëra e këtij pozicioni nuk mundë tă jetë më e lartë se 40% e shumës totale	perushall	1	3,500.00	3,500.00
Shuma e përgjithshme tabela 3					3,500.00




	Pershkrimi	Njësi	Sasia	Cmimi per njësi	Shuma
4	Pastrimi i fiksit magorë nga shembjal e dheut (gurëve) nese paraqitet nevoja gjatë sezonit dimorë, të logaritjet ngarkimi, transporti deri në 5 km	m <sup>2</sup>	60	10.00	600.00
Shuma e përgjithshme tabela 4					600.00
Totali tabela 1+2+3+4					11,849.00
Totali tabela për dy sezona					23,698.00
Kontraktuesi është i obliguar në momentin e nënshkrimit të kontratës së pakut 1/3 e sasisë së krypës ta ketë të siguruar në depo					

Mund të oferohet deri në 4 numra pas përsjes dijetore

Nr	Pershkrimi i rrugëve	Gjatësi (m <sup>2</sup> )	Gjersi (m)	Superfaqja me asfalt m <sup>2</sup>	Sasia e hudhjes se kripës kg/m <sup>2</sup>	Ditet e planifikuar me rëshje per hënëja të krypës	Sasia e hudhjes se kripët kg/m <sup>2</sup> per një hënë	Sasia e hudhjes se kripës kg/m <sup>2</sup> per 30 herë
1	Klegkë	6000	4	24000	0.02	30	480	14400
2	Divjakë	2500	3	7500	0.02	30	150	4500
	<b>TOTALI</b>	<b>8.500</b>		<b>31.500</b>			<b>630</b>	<b>18.900</b>

<b>Kapaciteti profesional</b>		
1	Projektymenaxheri: Inxhier bercholar i Industrisë apo komunikacionit	1
2	Puntor fizik	2

Mjetet e punës	Njësi	Sasia
1 Kamion me mekanizem per sargimin e boreve (plagun) me hedhje të kripës	copë	1
2 Ngarkues i madhë (Lugë) si dhe makina gryeve e shfreses së skullit (Greder) nese paraqitet nevoja per harrjen e shfreses së skullit ne muga	copë	1



## KONTRATA PUBLIKE KORNİZË

### 613-25-5004-2-1-1/C1106

Kuvendi Komunal Lipjan të cilën e përfaqëson, Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit në Lipjan z. Bekim Shabani në njëren anë (në tekstin e mëtejmë) Autoriteti Kontraktues; dhe

**N.T.P. LULISHTJA BUÇAJ, GUSHTERICË E ULËT, GRAÇANICË**, (ne vazhdim “Ofruesi i Shërbimeve”), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:

Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror 6 Llote me numër identifikues: 613-25-5004-2-1-1

#### **Neni 1                  Lënda**

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim: **Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror pjesa përendimore 2, llot 4, sipas kesaj kontrate dhe paramasës e cila është pjesë përbërese e kësaj kontrate.**

**a) Largimi I Borës nga rruga:**

**b) Hedhja e krypës të kombinuar me rërë :**

Largimi i borës nga rruga duhet të bëhet në mënyr të vazhdushme 24<sup>h</sup>:

Për qdo ditë të reshjeve të borës varsishtë nga koha kur fillojnë , fillimi i punës duhet të jetë i menjëhereshem pas fillimit të reshjeve.

Nese ato janë të panderprera largimi I borës dhe akullit duhet të bëhet pa nderprerë, ku të gjitha rrugët duhet të janë të pastruara, para kohës kur fillon fluksi i para kohes kur fillon fluksi i automjeteve (ora 7 e mengjesit)

**Vrejtje:** Në rastë të mos largimit të borës dhe akullit nga rrugët , kompanisë do t'i minusohet shuma për pastrimin e atyre rrugëve në bazë ditore bazë ditore.

Në rastë kur kompania pranon vërejtjen, vazhdon mosperfilljen e respektimit të marrëveshtjes atëhere kompanisë do t'i shkputet kontrata .

Kur kompanija ka defekte në makineri kompania duhet të lajmroj me shkrim organin mbikqyrës ose me email dhe duhet të caktojkohën kur mund kohen kur mundet të filloj me shërbime:

Në rastë kur mekanizmi nuk mund të rregullohet mbrenda ditës, operatori është i obliguar të huazoj apo të marrë makineri me qera per perfundimin esherbimeve te kontratuara, ne te kunderten operatori do te shpallet papergjegjeshem

Hedhja e krypës e kombinuar me rërë duhet të bëhet kur temperaturat nuk arrijnë -6° C në rastë se temperaturat kapin vlerat më të ulëta duhet të perdoret makineria (Greder) per gryerjen e bores dhe akullit nga rruga: Kontraktuesit do t'i bëhet pagesa vetem per shërbimet e kryera, kur rrugët konstatohen se janë të pastruara nga Bora dhe akulli dhe çdo intervenim te hedhjes se krypes dhe rëres , ndersa per rrugët te cilat nuk janë pastruara mbrenda 24<sup>h</sup> pas reshjeve nuk do te paguhen, si dhe do te minusohen me penalti 10 € per Km qdo ditë te papastruar.

**Kompanija duhet të ketë kujdestari 24<sup>h</sup> gjatë sezonit dimërorë:**

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek Ofruesi i sherbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendor në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 15 nëntor 2025 dhe përfundon në datën 15 prill 2027

#### Neni 2                   Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë 1 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë:

Nr	Pershkrimi i rrugëve	Gjatësi (m')	Gjersi (m)	siperfaqja-me asfalt m <sup>2</sup>	Sasia e hudhjes se kripes kg/m <sup>2</sup>	Ditet e planifikuave me reshje per hedhje te krypes	Sasia e hudhjes se kripes kg/m <sup>2</sup> 1 herë	Sasia e hudhjes se kripes kg/m <sup>2</sup> per 30 herë
	Lipjan Hallaq i Madh	4600	4	18400	0.02	30	368	11040
	Kraishtë	5500	4	22000	0.02	30	440	13200
	Ribari i Madh	9460	5	47300	0.02	30	946	28380
	Zllakuqan	2600	4	10400	0.02	30	208	6240
	Magure	4500	4	18000	0.02	30	360	10800
	Medvec	2500	4	10000	0.02	30	200	6000
	Harilaq i Vogël	1000	4	4000	0.02	30	80	2400
	Vrelle Magures	2000	4	8000	0.02	30	160	4800
	Qylagë	1000	4	4000	0.02	30	80	2400
	Vërshevc	7200	5	36000	0.02	30	720	21600
	Leletiq	2000	5	10000	0.02	30	200	6000
	Dobraj e Madhe	10500	5	52500	0.02	30	1050	31500
	Gilanicë	2100	4	8400	0.02	30	168	5040
	Gilanicë-Torin	1500	4	6000	0.02	30	120	3600
	Lluga	3200	4	12800	0.02	30	256	7680
	Dobraj e Vogël-Medvec	3200	4	12800	0.02	30	256	7680
	Poturovc	2100	4	8400	0.02	30	168	5040

	Torinë	2000	4	8000	0.02	30	160	4800
	Ribari Vogël	3000	5	15000	0.02	30	300	9000
	Ribari i Vogël-Torin	2000	5	10000	0.02	30	200	6000
	Rufci i Ri -Hallaq i Madh	1500	5	7500	0.02	30	150	4500
	Rufci i Ri	2200	4	8800	0.02	30	176	5280
	Rufci i Vjeter	3500	5	17500	0.02	30	350	10500
	Hallaqi Vogël	2700	4	10800	0.02	30	216	6480
	Grack e Vjeter	4000	4	16000	0.02	30	320	9600
	Jeta e Re	4200	4	16800	0.02	30	336	10080
	Topliqan	4500	5	22500	0.02	30	450	13500
	Topliqan-Grack e Vogel	2000	4	8000	0.02	30	160	4800
	Grack e Vogël	3200	5	16000	0.02	30	320	9600
	Bujanë	2300	5	11500	0.02	30	230	6900
	Bregu i Zi	5000	5	25000	0.02	30	500	15000
	Varigovc	3500	5	17500	0.02	30	350	10500
	Bregu i Zi - Kraishtë	1700	4	6800	0.02	30	136	4080
	<b>T O T A L I</b>	<b>112,260</b>		<b>506,700</b>			<b>10134.00</b>	<b>304,020.0</b>

### Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës është **63,222.48** Euro. Devijimi i lejuar nga vlera totale indikative është [+30%].

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të janë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqanta të Kontratës.

### Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknikë;

- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.



5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrëthanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet Shqipe në tri originale, dy originale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Ofruesin e Shërbimeve

Bekim Shabani	Emri:	<i>SHËRTGET</i>
Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	<i>Zyrtar drejtov</i>
<i>E. Shabani</i>	Nënshkrimi:	<i>I. Shabani</i>
<i>03.09.2025</i>	Data:	<i>03/09/2025</i>
	Vula:	<i>BUÇA</i>



## KUSHTET E PËRGJITHSHME

### Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofritesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat pér këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofritesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofritesit të Shërbimeve.

1.3 "Ofrites i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grapi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që pér detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofitesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar pér kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme pér ofrimin e Shërbimeve.

1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligor ose transferimet e lejuara, pér të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofitesi i Shërbimeve.

1.7 "Palë" nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofitesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 "KPK" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

### Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

### Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofitesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofitesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojet kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë pér pagesë, në favor të bankierëve të Ofritesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofritesit të Shërbimeve siguruesve të Ofritesit të Shërbimeve pér të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofitesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofitesin e Shërbimeve nga obligimet e veta pér pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose pér pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen pér dhënen e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

## **Neni 4 Nën-kontraktimi**

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofrores i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Ofrores i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofroresin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofrores i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofrores i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofroresit të Shërbimeve, agentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofroresin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

## **Neni 5 Tatimi**

5.1 Ofrores i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit te shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofrores i Shërbimeve.

## **Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve**

6.1 Ofrores i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofrores i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimitari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofrores i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktiviteteve.

## **Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit**

7.1 Ofrores i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëren nga këto arsy:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofrores i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvçëse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofroresit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjtë pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

#### Neni 8                  **Forca Madhore**

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tillë parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetat, shtrëngatat, vetëtima, vërvshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përbush detyrimet e saj tanë e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrëthanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrëthanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tillë alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

#### Neni 9                  **Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues**

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuan me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përvëç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njofshit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zgjedhur në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofreusin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpërt kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

#### Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve pér humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

#### Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofrues i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai,

duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofrofresi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofrofresi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të batojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofrofresi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tillë do të janë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbëja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofrofresi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuara në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkese me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitetë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

## Neni 12            Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofrofresit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të janë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tillë duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofrofresin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

## Neni 13            Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofrofresi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofrofresit te Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofrofresit te Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërsi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofrofresin e Shërbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofrofresi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofrofresi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofrofresi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë

koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

*b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofriuesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofriuesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

*c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetet e tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofriuesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofriuesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

*a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetet e tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofriuesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofriuesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

**Neni 14      Siguria e Ekzekutimit**

14.1 Ofriuesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofriuesit të Shërbimeve.

14.2 Garacioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

**Neni 15      Sigurimi që do të merret nga Ofriuesi i Shërbimit**

15.1 Ofriuesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rrëziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofriuesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

**Neni 16      Parimet të përgjithshme të pagesave**

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se leshuar nga Ofriuesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofriuesi

i Shërbimeve. I njëjtë formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbytjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të jepë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

#### Neni 17            Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KV.K. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç eshte definuar në KV.K.

#### Neni 18            Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektit të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim përmungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshtruhet në nenin 13.1.

#### Neni 19            Konsekuençat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprejje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpérblime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### **Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje përfundimtare që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim përqindrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe përfundon zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkosës përfundimtare zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkosës. Periudha maksimale që jepet përfundimtare arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja përfundimtare zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkosave përfundimtare zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpjigen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### **Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore përfundimtare zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin përfundimtare zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

#### **Neni 22 Dëmshpérblimi**

22.1 Ofruesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpérblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jete përgjegjës përfundimtare zgjidhjes së mosmarrëveshjes, shkrirës apo shkrirës së ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

## KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kurseve të përmendura për nenit përkatës të KPK. Fshini ato jo relevante.]*

<b>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</b>		<b>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</b>
<b>Përshkrimi i nenit</b>	<b>Nr. Nenit</b>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridikioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Fillimi Përfundimi shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është <b>15.11.2025-15.04.2026, dhe sezona e dyte: 15.11.2026-15.04.2027</b>
	6.4	Data e Përfundimit është <b>15.04.2027</b>
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është : <i>sipas paramasës dhe KPK</i>
Obligim kontraktuesit	I	<b>Kontraktuesi eshte i obliguar ne momentin e nenshkrimit te kontrates se paku 1/3 e sasise se krypes ta kete te siguruuar ne depo.</b>
inspektimi	7.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do tëjenë si në vijim: Kontrollimi i shërbimeve do të kryhet nga momenti i fillimit të reshjeve, kontrolli do të kryhet edhe nga inspektoret e trafikut dhe Policia e Kosovës dhe çdo vërejtje që jepet nga këto instucione do të merren parasysh.
penalet	8.1	Kontraktuesi duhet të intervenoj për largimin e borës pas fillimit te reshurave ku trashësia e bores arrin 3 cm, Kur konstatohen se rrugët janë te pastruara nga bora dhe akulli 24 orë pas ndërprerjes së të reshurave dhe është pengesë përlëvizjen e lirë të qytetarëve dhe automjeteve do të ekzekutohen penalet prej 10€ për çdo km të pa pastruar për çdo ditë sa janë rrugët e pa pastruara.
Obligimet Autoritetit Kontraktues	e	Menaxheri i Projektit caktohet Besart Zejnullahu, ndersa MDMK Enver Elshani.
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është <b>0.25%</b> në ditë.  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është <b>[10% e Çmimit të Kontratës]</b> të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: 10% e vlerës së kontratës apo shprehur nominalisht, 6.322.24€, për periudhën kohore 30 muaj.
Sigurimi që do të	15.1	(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me

merret nga ofruesi i shërbimeve		<p>punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, përfshirë çfarëdo arsy, përpos rreziqeve të definuar sipas nenit 38 te KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkësave të menaxherit te kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë;</p> <p>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme përfshirë zëvendësimin e tyre;</p> <p>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impanteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 5.000 euro përfshirë çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</p> <p>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</p> <p style="padding-left: 2em;">e punëtorëve të Kontraktuesit: 20000 euro përfshirë çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p> <p>a) e personave të tjera: 20000 euro përfshirë çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p>
Parimet përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: Orari i pagesës do të jetë: Pagesa do të kryhet në fund të sezonit dmth do të kemi vetëm dy pagesa , pagesa e parë do të kryhet në fund të sezonit 2025-2026 , pagesa e dytë në fund të sezonit 2026-2027. Për shumën e kontraktuar nëse ka penale , menaxheri i kontratës do t'i llogarit dhe do të zbret faturën përvleren e penaleve që i konstaton menaxheri i kontratës
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: Kontrollimi i shërbimeve do të kryhet nga momenti i fillimit të reshjeve, kontrolla do të kryhet edhe nga inspektoret e trafikut dhe Policia e Kosovës dhe çdo vërejtje që ipet nga këto instucionë do të merren parasysh
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<b>Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave</b>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatën Themelore-Prishtinë</b> në</p> <p style="background-color: #cccccc; padding: 2px;"><b>në pajtim me ligjin në Kosovë</b></p> <p>ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <b>Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës</b>, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p><b>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin përmënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi</b></p>



Poz.	Pershkrimi	Njesia	Sasia	çmimi njësi	Shuma
2	Furnizimi dhe deponimi i kypës me fillimin e sezonit dimërorë,	kg	304,020.00	0.0020	608.04
	Shuma e përgjithshme tabela 2				
					608.04

	Pershkrimi	njësia	sasia	çmimi per një sezon	shuma
3	Kompanija duhet të caktoj Çmimin përkujdestari gjatë sezonit dimorë 2023/2025, vlera e këtij pozicioni nuk mundë të jetë më e lartë se 40% e shumës totale	paushall	1	12,750.00	12,750.00

Shuma e përgjithshme tabela 3	12,750.00
-------------------------------	-----------

	Pershkrimi	njësia	sasia	Cmimi per njësi	Shuma
4	Pastrimi i aksit rrugorë nga shembjet e dheut (gurëve) nese paraqitet nevoja gjatë sezonit dimëror, të	m³	60	0.20	12.00

ilogaritet ngarkimi, transporti deri në 5 km		
Shuma e përgjithshme tabela 4		12.00

Totali tabela 1+2+3+4	31,611.24
Totali tabela për dy sezona	63,222.48
Kontraktuesi është I obliguar në momentin e nënshkrimit të kontratës së paku 1/3 e sasisë së krypës ta ketë të siguruar në depo	
Mundë të ofertohet deri në 4 numra pas presjes dhjetore	

Nr	Pershkrimi i rrugëve	Gjatësi (m')	Gjersi (m)	siperfa qja-me asfalt m <sup>2</sup>	Sasia e hudhjes se kripes kg/m <sup>2</sup>	Ditet e planifi kuave me reshje per hedhjet e krypes	Sasia e hudhjes se kripes kg/m <sup>2</sup> 1 herë	Sasia e hudhjes se kripes kg/m <sup>2</sup> per 30 herë
1	Lipjan Hallaq i Madh	4600	4	18400	0.02	30	368	11040
2	Kraishtë	5500	4	22000	0.02	30	440	13200
3	Ribari i Madh	9460	5	47300	0.02	30	946	28380
4	Zllakuqan	2600	4	10400	0.02	30	208	6240
5	Magure	4500	4	18000	0.02	30	360	10800
	Medvec	2500	4	10000	0.02	30	200	6000
	Harilaq i Vogël	1000	4	4000	0.02	30	80	2400
	Vrelle Magures	2000	4	8000	0.02	30	160	4800
	Qylagë	1000	4	4000	0.02	30	80	2400
	Vërshevc	7200	5	36000	0.02	30	720	21600
	Leletiq	2000	5	10000	0.02	30	200	6000

	Dobraj e Madhe	10500	5	52500	0.02	30	1050	31500
	Gllanicë	2100	4	8400	0.02	30	168	5040
	Gllanicë-Torin	1500	4	6000	0.02	30	120	3600
	Lluga	3200	4	12800	0.02	30	256	7680
	Dobraj e Vogël-Medvec	3200	4	12800	0.02	30	256	7680
	Poturovc	2100	4	8400	0.02	30	168	5040
	Torinë	2000	4	8000	0.02	30	160	4800
	Ribari Vogël	3000	5	15000	0.02	30	300	9000
	Ribari i Vogël-Torin	2000	5	10000	0.02	30	200	6000
	Rufci i Ri - Hallaq i Madh	1500	5	7500	0.02	30	150	4500
	Rufci i Ri	2200	4	8800	0.02	30	176	5280
	Rufci i Vjeter	3500	5	17500	0.02	30	350	10500
	Hallaqi Vogël	2700	4	10800	0.02	30	216	6480
	Grack e Vjeter	4000	4	16000	0.02	30	320	9600
	Jeta e Re	4200	4	16800	0.02	30	336	10080
	Topliqan	4500	5	22500	0.02	30	450	13500
	Topliqan-Grack e Vogel	2000	4	8000	0.02	30	160	4800
	Grack e Vogël	3200	5	16000	0.02	30	320	9600
	Bujanë	2300	5	11500	0.02	30	230	6900
	Bregu i Zi	5000	5	25000	0.02	30	500	15000
	Varigovc	3500	5	17500	0.02	30	350	10500
	Bregu i Zi - Kraishtë	1700	4	6800	0.02	30	136	4080
	<b>T O T A L I</b>	<b>112,260</b>		<b>506,700</b>			<b>10134.00</b>	<b>304,020.0</b>

**Kapaciteti  
profesional**

1	Projektmenaxheri: Inxhinjer barchlor I ndertimtarisë apo komunikacion it me tri vjet pervoja punje		1
2	Puntor fizik		6

Mjetet e punës		Njësia	Sasia
1	Kamion me mekanizem per largimin e bores (pllugun) me hedhes te kripës	copë	2
2	Ngarkues i madhë (Lugë) si dhe makinë gryese e shtreses së akullit ( Greder ) nese paraqitet nevoja per heqjen e shtreses së akullit ne rruge	copë	1

## KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

Kuvendi Komunal Lipjan të cilën e përfaqëson, Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit në Lipjan z. Bekim Shabani në njëren anë (në tekstin e mëtejmë) Autoriteti Kontraktues; dhe

**RSM Company SH.P.K., Çagllavice, P.N., PRISHTINË**, (ne vazhdim “Ofruesi i Shërbimeve”), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike pér Shërbimet në vijim:

**Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror 6 Llote me numër identifikues: 613-25-5004-2-1-1**

**Neni 1                   Lënda**

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit pér kryerjen e shërbimeve në vijim:

**Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror pjesa lindore 2, llot 3, sipas kesaj kontrate dhe paramasës e cila është pjesë përbërëse e kësaj kontrate.**

**a) Largimi I Borës nga rruga:**

**b) Hedhja e krypës të kombinuar me rërë :**

Largimi i borës nga rruga duhet të bëhet në mënyr të vazhdushme 24<sup>h</sup>:

Për qdo ditë të reshjeve të borës varsishtë nga koha kur fillojnë , fillimi i punës duhet të jetë i menjëhereshem pas fillimit të reshjeve.

Nese ato janë të panderprera largimi I borës dhe akullit duhet të bëhet pa nderprerë, ku të gjitha rrugët duhet të jenë të pastruara, para kohës kur fillon fluksi i para kohes kur fillon fluksi i automjeteve (ora 7 e mengjesit)

**Vrejtje:** Në rastë të mos largimit të borës dhe akullit nga rrugët , kompanisë do t'i minusohet shuma pér pastrimin e atyre rrugëve në bazë ditore bazë ditore.

Në rastë kur kompania pranon vërejtjen, vazhdon mosperfilljen e rrespektimit të marrëveshtjes atëhere kompanisë do t'i shkputet kontrata .

Kur kompanija ka defekte në makineri kompania duhet të lajmroj me shkrim organin mbikqyrës ose me email dhe duhet të caktojkohën kur mund kohen kur mundet të filloj me sherbime:

Në rastë kur mekanizmi nuk mund të rregullohet mbrenda ditës, operatori është i obliguar të huazoj apo të marrë makineri me qera per perfundimin esherbimeve te kontraktuara, ne te kunderten operatori do te shpallet papergjegjeshem

Hedhja e krypës e kombinuar me rërë duhet të bëhet kur temperaturat nuk arrijnë -6° C në rastë se temperaturat kapin vlerat më të ulëta duhet të perdoret makineria (Greder) per gryerjen e bores dhe akullit nga rruga:  
Kontraktuesit do t'i bëhet pagesa vetem per sherbimet e kryera, kur rruget konstatohen se janë të pastruara nga Bora dhe akulli dhe çdo intervenim te hedhjes se krypes dhe rëres , ndersa per rruget te cilat nuk janë të pastruara mbrenda 24<sup>h</sup> pas reshjeve nuk do te paguhen, si dhe do të minusohen me penaltı 10 € per Km qdo ditë te papastruar.

**Kompanija duhet të ketë kujdestari 24<sup>h</sup> gjatë sezonit dimërorë:**

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek Ofruesi i sherbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasisë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(ët) Kontraktues i përmendor në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 15 nëntor 2025 dhe përfundon në datën 15 prill 2027

#### Neni 2                   Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë 1 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë :

Nr	Pershkrimi i rrugëve	Gjatësi (m')	Gjersi (m)	siperfaqja-me asfalt m <sup>2</sup>	Sasia e hudhjes se kripes kg/m <sup>2</sup>	Ditet e planifikuar me reshje per hedhje te kripes	Sasia e hudhjes se kripes kg/m <sup>2</sup> për 1 herë	Sasia e hudhjes se kripes kg/m <sup>2</sup> per 30 herë
1	Brusi (1) Ruga e Ministris	3000	5	15000	0.02	30	300	9000
2	Brus -2	5900	3	17700	0.02	30	354	10620
	T O T A L I	8900		<b>32700</b>			654	<b>19620</b>

#### Neni 3   Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës është **23,149.20** Euro. Devijimi i lejuar nga vlera totale indikative është [+30%].

3.2 Çmimi i përmendor në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të jenë fiksë dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqanta të Kontratës.

#### Neni 4   Rendi i përparsisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;

- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.



5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet Shqipe në tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Bekim Shabani	Emri:	<i>SHFAT KAMERI</i>
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	<i>JURIST</i>
Nënshkrimi:	<i>F. Shabani</i>	Nënshkrimi:	<i>J. Hoxha</i>
Data:	04.09.2025	Data:	04.09.2025
Vula:		Vula:	



## KUSHTET E PËRGJITHSHME

### Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Ofrcesi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofrcesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofrcesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përbushin kërkesat e pershatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofrcesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofrcesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofrcesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

#### **Neni 5 Tatimi**

5.1 Ofrcesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit te shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofrcesi i Shërbimeve.

#### **Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve**

6.1 Ofrcesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofrcesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimitari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofrcesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktivitetave.

#### **Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit**

7.1 Ofrcesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëron nga këto arsyë:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofrcesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvèçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofrcesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjtë pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

#### Neni 8                  **Forca Madhore**

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrrëgullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërvshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paftësinë e një pale të tillë që të përbush detyrimet e saj tanë e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

#### Neni 9                  **Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues**

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përvëç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

#### Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimesht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

#### Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofrues i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai,

duke iu ekspozuar dënitmit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofrofuesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmitt e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofrofuesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofrofuesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tillë do të janë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbëja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofrofuesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuara në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkese me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

## Neni 12              Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofrofuesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të janë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tillë duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofrofuesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj “Menaxherin e Projektit”, i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

## Neni 13              Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofrofuesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha sherbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofrofuesit te Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofrofuesit te Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofrofuesin e Shërbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofrofuesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënen e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofrofuesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofrofuesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë

koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

*b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofroresi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofroresi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

*c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetetve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofroresi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofroresi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

*a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetetve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofroresi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofroresi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

**Neni 14      Siguria e Ekzekutimit**

14.1 Ofroresi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofroresit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

**Neni 15      Sigurimi që do të merret nga Ofroresi i Shërbimit**

15.1 Ofroresi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofroresi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

**Neni 16      Parimet të përgjithshme të pagesave**

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet te bëhen sipas faturës se leshuar nga Ofroresi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofroresi

i Shërbimeve. I njëjtë formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbytjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i jasin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

#### **Neni 17                   Kualiteti i Kontrollit**

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç eshte definuar në KVK.

#### **Neni 18                   Përmirësimi i Defekteve**

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektit të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim përmes Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

#### **Neni 19                   Konsekuençat e Shkeljes se kontratës**

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërbime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje pér të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim pér qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe pér ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkесës pér zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkесës. Periudha maksimale që jepet pér arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja pér të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkësave pér zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiken të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore pér zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin pér mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

#### Neni 22 Dëmshpërbimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërbilej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jete përgjegjës pér te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

## KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kurseive të përmendura për nenit përkatesë të KPK. Fshini ato jo relevante.]*

<b>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</b>		<b>Anandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatesë në KPK</b>
<b>Përkrimi i nenit</b>	<b>Nr. Nenit</b>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksiioni do të jetë gjykata përkatesë në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Fillimi Përfundimi shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është <b>15.11.2025-15.04.2026, dhe sezona e dyte: 15.11.2026-15.04.2027</b>
	6.4	Data e Përfundimit është <b>15.04.2027</b>
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është : <i>sipas paramasës dhe KPK</i>
Obligim kontraktuesit	I	<b>Kontraktuesi eshte i obliguar ne momentin e nenskrimit te kontrates se paku 1/3 e sasise se krypes ta kete te sigruuar ne depo.</b>
inspektimi	7.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: Kontrollimi i shërbimeve do të kryhet nga momenti i fillimit të reshjeve, kontrolli do të kryhet edhe nga inspektoret e trafikut dhe Policia e Kosovës dhe çdo vërejtje që jetet nga këto instucionë do të merren parasysh.
penalet	8.1	Kontraktuesi duhet të intervenoj për largimin e borës pas fillimit te resharave ku trashësia e bores arrin 3 cm, Kur konstatohen se rrugët janë te pastruara nga bora dhe akulli 24 orë pas ndërprerjes së të reshurave dhe është pengesë për lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe automjeteve do të ekzekutohen penalet prej 10€ për çdo km të pa pastruar për çdo ditë sa janë rrugët e pa pastruara.
Obligimet Autoritetit Kontraktues	e	Menaxheri i Projektit caktohet Burim Kodra, ndersa MDMK Bujar Curri.
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është <b>0.25%</b> në ditë.  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është <b>10% e Çmimit të Kontratës</b> , të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: 10% e vlerës së kontratës apo shprehur nominalisht, 6.679.20€, për periudhën kohore 30 muaj.
Sigurimi që do të	15.1	(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me

merret nga ofruesi i shërbimeve		<p>punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsy, përpos rreziqeve të definuar sipas nentit 38 te KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit te kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjëri në koston e zëvendësimit të plotë;</p> <p>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</p> <p>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 5.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</p> <p>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</p> <p>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 20000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p> <p>a) e personave të tjera: 20000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p>
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: Orari i pagesës do të jetë: Pagesa do të kryhet në fund të sezonit dmth do të kemi vetëm dy pagesa , pagesa e parë do të kryhet në fund te sezonit 2025-2026 , pagesa e dytë në fund të sezonit 2026-2027. Për shumën e kontraktuar nëse ka penale , menaxheri i kontratës do t'i llogarit dhe do të zbret faturën përvleren e penaleve që i konstaton menaxheri i kontratës
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: Kontrollimi i shërbimeve do të kryhet nga momenti i fillimit të reshjeve, kontrolla do të kryhet edhe nga inspektoret e trafikut dhe Policia e Kosovës dhe çdo vërejtje që ipet nga këto instucionë do të merren parasysh
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<b>Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave</b>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatën Themelore-Prishtinë</b> në</p> <p><b>në pajtim me ligjin në Kosovë</b></p> <p>ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <b>Tribunali i Përherëshëm i Arbitrazhit të Kosovës</b> në kuadër të <b>Odës Ekonomike të Kosovës</b>, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin përmënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi</p>

Mirëmbajtja dhe pastimi i rrugëve rurale për dy sezonat dimorore 2023/2024 dhe 2024/2025 pjesa II ndore në Komunën e Lipjanit- Loti 2							
Aktivitet							
Poz.	Pershkrimi	Njësia	Gasha	çmimi njësi	Çmimi per 1 (një) herë e badhje se kryes per (m²)	Shifrat e sezonit	Shuma e përgjithshme për sezon
1	Largimi i borës nga rrugët sipes specifikacioneve të pamparave me aktivitetet: a) largimi i borës nga rruga,b) hudhja e kripës Vrejtje: me këtë pozicion duhet të jepet qmëni per m² për të gjitha rrugët e parapara sipes specifikimeve për mirëmbajtjen e një m² të rrugës, për largimin e borës dhe hudhjen e kryesës së dritës kur ka të restura;	m²	691,550,00	0,0008	355,00	50,00	10,650,00

Poz.	Pershkrimi	Njësia	Gasha	çmimi njësi	Shuma
2	Furnizimi dhe deponimi i kypës me filmin e sezonit dimoror,	kg	328,830,00	0,0280	9,536,07

Pershkrimi	njësia	Kasa	çmimi per një sezon	Shuma
3 Kompania duhet tă caktoj Çmimin për kujdestari gjatë sezonit dimoror 2023/2025 Vira e këtij pozicioni nuk mundët të jetë më e lartë se 40% e shumës totale	pashall	1	13000	13,000,00

Shuma e përgjithshme tabela 3 13,000,00



	Pershikimi	Njësie	Sasia	Cmimi per njësi	Shtresa
4	Pashkimi i teknikëve rreth shembujve e dhaat (gurëve) nese parashiket nevoja gjatë sezonit dimorar, të kushtetit nparkimi, transporti deri në 5 km	m <sup>2</sup>	60	3,60	210,00
Shuma e përgjithshme tabela 4					210,00

Totali tabela 1+2+3+4 për njës sezonë	33,396,07
Totali për dy sezonë	66,792,14


Mund tă ofertohet deri në 4 numra pas presjes dhetore

Kontraktuesi është i obliguar në momentin e nënshkrimit të kontratës së pakut 1/3 e sasisë së krypes ta ketë të siguruar në depo

Nr	Punë të planifikuar	Orazi (m <sup>2</sup> )	Orazi m <sup>2</sup>	Superfakte - me rrafshi	Sasia e hordhjes se krypes kg/m <sup>2</sup>	Dita të planifikuar me rrafshi per krypet	Sasia e hordhjes se krypes (Kg) m <sup>2</sup> per 1 hektar	Sasia e hordhjes se krypes kg/m <sup>2</sup> per 30 herë
1	Hekurudh-Kosjk	5510	3	27550	0,020	30	551	16530
2	Rubova i Vugri	1500	4	5200	0,020	30	104	3120
3	Rubova i Madhe	3500	4	14000	0,020	30	280	8400
4	Llugaçhi-Rubova	4500	5	22500	0,020	30	450	13500
5	Gjomarash	3000	3	15000	0,020	30	300	9000
6	Bamallë	9000	3	45000	0,020	30	900	27000
7	Gjogavce	6000	5	30000	0,020	30	600	18000
11	Silvix	7500	6	45000	0,020	30	900	9000
12	Siliqzi-Turbore	3000	5	25000	0,020	30	500	15000
13	Senshulit	6500	5	32500	0,020	30	690	20700
14	Qazanek	1200	4	4800	0,020	30	96	2880
15	Gjedhesë Ulli-e Epërme	15000	6	90000	0,020	30	1800	54000
16	Balnucë i Muhajterave	5500	5	27500	0,020	30	550	16500
17	Vrellë e Gjinimes	7500	4	30000	0,020	30	600	18000
18	Vrellë Përkoviq	5000	4	20000	0,020	30	400	12000
19	Manovë-Glavëzë	2500	5	14500	0,020	30	290	8700
20	Gjedhesë - Smakëzë	3500	5	17500	0,020	30	350	10500
21	Gjedhesë - Gjavëzë	3500	5	17500	0,020	30	350	10500
22	Shigjet e Eçses- Gjadime	2500	5	12500	0,020	30	250	7500
23	Shigjet e Eçses- Silvix	2500	3	7500	0,020	30	150	4500
24	Gusheterë e Nalë - Akllap	7500	4	30000	0,020	30	600	18000
25	Jasujevë - të gjitha rragët	9500	6	39000	0,020	30	760	22800
26	Toqe	2000	4	8000	0,020	30	160	4800
27	Kruja - Sëboni Akllap	2000	3	16000	0,020	30	200	6000
<b>T O T A L I</b>		<b>122210</b>		<b>591550,0</b>			<b>11831</b>	<b>328830</b>

Kapaciteti profesional		
1	Projektoherë/Inxhinier banchor i identifikuar apo komunikuar me lëvizjet punë	1
2	Punor fizik	0

	Mjetet e punës	Njësie	Sasia
1	Kension me mekanizem per largimin e borës (pllugun) me hedhjen te krypes	copë	2
2	Njarkues i madhi (Luge) si dhe makine grycerë e shpresë së aktivitës (Gredor) nese parashiket nevoja për herjen e shpresës së aktivitës në ndje	COPË	1



**KONTRATA PUBLIKE KORNIZË**  
**613-25-5004-2-1-1/C1103**

Kuvendi Komunal Lipjan të cilën e përfaqëson, Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit në Lipjan z. Bekim Shabani në njëren anë (në tekstin e mëtejmë) Autoriteti Kontraktues; dhe

**GASHI EG SH.P.K., Rr. Qerim Banulla, nr. 16, Lipjan, Kosove,** (ne vazhdim “Ofruesi i Shërbimeve”), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:

**Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror 6 Llote me numër identifikues: 613-25-5004-2-1-1**

**Neni 1                    Lënda**

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim: **Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror në qytetin e Lipjanit, lloji 1, sipas kesaj kontrate dhe paramasës e cila është pjesë përbërese e kësaj kontrate.**

**a) Largimi I Borës nga rruga:**

**b) Hedhja e krypës të kombinuar me rërë :**

Largimi i borës nga rruga duhet të bëhet në mënyr të vazhdushme 24<sup>h</sup>:

Për qdo ditë të reshjeve të borës varsishtë nga koha kur fillojnë , fillimi i punës duhet të jetë i menjëherës pas fillimit të reshjeve.

Nese ato janë të panderprera largimi I borës dhe akullit duhet të bëhet pa nderprerë, ku të gjitha rrugët duhet të janë të pastruara, para kohës kur fillon fluksi i para kohës kur fillon fluksi i automjeteve (ora 7 e mengjesit)

**Vrejëtje:** Në rastë të mos largimit të borës dhe akullit nga rrugët , kompanisë do t'i minusohet shuma për pastrimin e atyre rrugëve në bazë ditore bazë ditore.

Në rastë kur kompania pranon vërejtjen, vazhdon mosperfilljen e rrespektimit të marrëveshtjes atëhere kompanisë do t'i shkputet kontrata .

Kur kompanija ka defekte në makineri kompania duhet të lajmroj me shkrim organin mbikqyrës ose me email dhe duhet të caktojkojnë kur mund kohen kur mundet të filloj me sherbime:

Në rastë kur mekanizmi nuk mund të rregullohet mbrenda ditës, operatori është i obliguar të huazoj apo të marrë makineri me qera per perfundimin esherbimeve te kontraktuara, ne te kunderten operatori do te shpallet papergjegjeshem

Hedhja e krypës e kombinuar me rërë duhet të bëhet kur temperaturat nuk arrijnë -6° C në rastë se temperaturat kapin vlerat më të ulëta duhet të perdoret makineria (Greder) per gryerjen e bores dhe akullit nga rruga: Kontraktuesit do t'i bëhet pagesa vetem per sherbimet e kryera, kur rruget konstatohen se janë të pastruara nga Bora dhe akulli dhe qdo intervenim te hedhjes se krypes dhe rëres , ndersa per rruget te cilat nuk janë të pastruara mbrenda 24<sup>h</sup> pas reshjeve nuk do te paguhen, si dhe do te minusohen me penalti 10 € per Km qdo ditë te papastruar.

**Kompania duhet të ketë kujdestari 24<sup>h</sup> gjatë sezonit dimërorë,**

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek Ofruesi i sherbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendor në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 15 nëntor 2025 dhe përfundon në datën 15 prill 2027

#### Neni 2                   Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë 1 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë :

Nr	Pershkrimi i rrugëve	Gjatësi (m <sup>l</sup> )	Gjersi bashkë me trotuar (m <sup>l</sup> )	siperfaqja-me asfalt dhe trotuar m <sup>2</sup>	Sasia e hudhjes se kripes kg/m <sup>2</sup>	Ditë te planifikuara me reshje per hudhje te kripës	Sasia e hudhjes se kripes kg/m <sup>2</sup> per 1 herë	Sasia e hudhjes se kripes kg/m <sup>2</sup> per 30 herë
1	Rr. Skenderbeu	650	11	7150	0.02	30	143	4290
2	L. e Prizerenit	400	17	6800	0.02	30	136	4080
3	K.Kumanova	400	17	6800	0.02	30	136	4080
4	Avdi Kelmendi	1000	17	17000	0.02	30	340	10200
5	Xhavit Kozhani	200	8	1600	0.02	30	32	960
6	Gjergj Fishta	212	8	1696	0.02	30	34	1018
7	Tahir Sinani	260	11	2860	0.02	30	57	1716
8	Shen Flori-Albani	300	11	3300	0.02	30	66	1980
9	Sadik Shala	1050	10	10500	0.02	30	210	6300
10	28 Nëntori	650	4	2600	0.02	30	52	1560
11	Zylfije Gashi	400	8	3200	0.02	30	64	1920
12	Hamz Jashari	160	9	1440	0.02	30	29	864
13	Fehmi Agani	300	9	2700	0.02	30	54	1620
14	Shqiperia	215	14	3010	0.02	30	60	1806
15	Haradin Bajrami	1000	17	17000	0.02	30	340	10200
16	Hamdi Bislimi	1000	8	8000	0.02	30	160	4800
17	Fehmi Lladrovci	200	6	1200	0.02	30	24	720
18	Qamil Olluri	600	9	5400	0.02	30	108	3240

19	Isa Olluri	400	8	3200	0.02	30	64	1920
20	Kongresi i Blinajes	300	8	2400	0.02	30	48	1440
21	Malet e Sharrit	300	8	2400	0.02	30	48	1440
22	Nën Tereza	570	7	3990	0.02	30	80	2394
23	Idriz Ajeti	300	8	2400	0.02	30	48	1440
24	Ramiz Shala	170	8	1360	0.02	30	27	816
25	Qerim Banulla	182	7	1274	0.02	30	25	764
26	Haxhi Kleqka	620	12	7440	0.02	30	149	4464
27	Grupi Rinor	350	4	1400	0.02	30	28	840
28	Millosh Kopiliqi	125	4	500	0.02	30	10	300
29	Aziz Kelmendi	315	4	1260	0.02	30	25	756
30	Xhevdet Breznica	250	4	1000	0.02	30	20	600
31	Shefki Salihu	1250	6	7500	0.02	30	150	4500
32	Jeton Fazliu	170	3	510	0.02	30	10	306
33	24 Marsi	220	4	880	0.02	30	18	528
34	Mihajl Pupin	125	4	500	0.02	30	10	300
35	Halil Meta	300	4	1200	0.02	30	24	720
36	12 Qershori	450	6	2700	0.02	30	54	1620
37	2 Korriku	300	4	1200	0.02	30	24	720
38	Shaqir Hoxha	300	5	1500	0.02	30	30	900
39	Mbretresha Teut	300	5	1500	0.02	30	30	900
40	Lulzim Llugiqi	50	4	200	0.02	30	4	120
41	Bashkim Krasniqi	750	8	6000	0.02	30	120	3600
42	Martiret e Lipjanit	350	6	2100	0.02	30	42	1260
43	Ulpiana	125	4	500	0.02	30	10	300
44	Enver Olluri	200	5	1000	0.02	30	20	600
45	Iliria	130	4	520	0.02	30	10	312
46	Ibrahim Krasniqi	120	4	480	0.02	30	10	288
47	Mbreti Agron	250	5	1250	0.02	30	25	750
48	Bejtush Gerbeshi	1050	8	8400	0.02	30	168	5040
49	Avdi Avdiu	100	4	400	0.02	30	8	240
50	Vezir Kolshi	100	4	400	0.02	30	8	240

51	Miftar Sopi	100	4	400	0.02	30	8	240
52	Bajram Curri	150	4	600	0.02	30	12	360
53	Isa Dema	200	4	800	0.02	30	16	480
54	Muzaqete Begolli	100	4	400	0.02	30	8	240
55	1-Maji	120	4	480	0.02	30	10	288
56	Mbreti Zog	120	6	720	0.02	30	14	432
57	Pjeter Bogdani	50	4	200	0.02	30	4	120
58	Martiret e Akllapit	430	5	2150	0.02	30	43	1290
59	Ali Hadri	170	4	680	0.02	30	14	408
60	Afrim Zhitija	200	5	1000	0.02	30	20	600
61	Sami Frasherri	100	5	500	0.02	30	10	300
62	Konjuhi	3500	7	24500	0.02	30	490	14700
63	Rr. Marie Shllaku	2000	8	16000	0.02	30	320	9600
63	Rr e tranzitit - Bajram Gashi-Sadik Shala	1500	8	12000	0.02	30	240	7200
	<b>TOTALI</b>	<b>28,259</b>		<b>230,050</b>			<b>4601</b>	<b>138030</b>

### Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës është **48,562.36** Euro. Devijimi i lejuar nga vlera totale indikative është [+30%].

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të janë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqanta të Kontratës.

### Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë konratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të pëparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

## Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofresit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.


5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlgimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlgim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendosë" "do të shenojen në përputhje me irrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet Shqipe në tri originale, dy originale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofresin e Shërbimeve.

### Për Autoritetin Kontraktues

### Për Ofresin e Shërbimeve

Bekim Shabani	Emri:	EFDINA GASHI
Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	PRETAKESUES I AUTORITETUAR
	Nënshkrimi:	Gashi
03.09.2025	Data:	03.09.2025
	Vula:	GASHI EG



## KUSHTET E PËRGJITHSHME

### Neni 1

### Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofresit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet që do te ekzekutohen nga ana e Ofresit e Shërbimeve në pajtim me Specifikitë dhe Përshkrin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofresit të Shërbimeve.

1.3 "Ofres i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grapi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyuar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 “**Personeli**” do të thotë personat e angazhuar nga Ofrcuesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 “**Çmimi i kontratës**” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 “**Nënkontraktuesi**” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofrcuesi i Shërbimeve.

1.7 “**Palë**” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofrcuesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “**Palët**” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 “**Autoriteti Kontraktues**” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Konratë.

1.9 “**KPK**” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “**KVK**” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

#### **Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm**

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në konratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

#### **Neni 3 Transferimi**

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofrcuesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofrcuesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvçë në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofrcuesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofrcuesit të Shërbimeve siguruesve të Ofrcuesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjeter i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofrcuesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofrcuesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitive të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvçë në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjeter financiar.

#### **Neni 4 Nën-kontraktimi**

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofrcuesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Ofrcuesi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofrcuesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofrcuesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përmblushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofrcuesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të

agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofrcesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofrcesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

#### Neni 5 Tatimi

5.1 Ofrcesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit te shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofrcesi i Shërbimeve.

#### Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofrcesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofrcesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofrcesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktiviteteve.

#### Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofrcesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsyë:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofrcesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkësë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvëçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofrcesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjtë pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofrcesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofrcesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

#### Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përbush detyrimet e saj tanë e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

#### Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u myllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofrcesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofrcesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofrcesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofrcesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofrcesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofrcesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofrcesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpert kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofrcesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

#### **Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofrcesi i Shërbimeve**

10.1 Ofrcesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofrcesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofrcesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofrcesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofrcesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofrcesit të Shërbimeve.

#### **Neni 11 Obligimet e Ofrcesit të Shërbimeve**

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofrcesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofrces i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofrcesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe t'i veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe t'i veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofrcesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të batojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofrcesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tillë do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofrcesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identikuara në tenderin e tij për të kryer funksionet e

përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkese me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

#### Neni 12            Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të janë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj “Menaxherin e Projektit”, i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

#### Neni 13            Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofrofuesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofrofuesit te Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofrofuesit te Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofrofuesin e Shërbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofrofuesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënen e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofrofuesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofrofuesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofrofuesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofrofuesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetet e tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofrofuesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofrofuesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofroes i sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofroesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

#### Neni 14      Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofroesi i sherbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofroesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

#### Neni 15      Sigurimi që do të merret nga Ofroesi i Shërbimit

15.1 Ofroesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe përmbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofroesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

#### Neni 16      Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se leshuar nga Ofroesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofroesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofroesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëherëshëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofroesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofroesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japid të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

#### Neni 17                    Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të janë si në KV.K. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkijnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç eshte definuar në KV.K.

#### Neni 18                    Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësoj koston e korrigimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

#### Neni 19                    Konsekuençat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërpërje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### Neni 20                    Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekë për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetren me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkësës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkësës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkësave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetren.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

**Neni 21            Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

**Neni 22    Dëmshpërbllimi**

22.1 Ofrcesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërbujej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofrcesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofrcesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofrcesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

## KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*(Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kurative të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshimi ato jo relevante.)*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshtimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridikioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Fillimi dhe Përfundimi shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është <b>15.11.2025-15.04.2026, dhe sezona e dyte: 15.11.2026-15.04.2027</b>
	6.4	Data e Përfundimit është <b>15.04.2027</b>
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është : <i>sipas paramasës dhe KPK</i>
Obligim kontraktuesit	I 6.6	<p><b>Kontraktuesi eshte i obliguar ne momentin e nenshkrimit te kontrates se paku 1/3 e sasise se krypes ta kete te sigruuar ne depo.</b></p> <p><b>Operatori ekonomik obligohet qe ne rast se bie sasi e madhe e bores t'a ngarkon dhe largon borena nga qyteti. Vlen vetem per llojt 1.</b></p>
inspektimi	7.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të janë si në vijim: Kontrollimi i shërbimeve do të kryhet nga momenti i fillimit të reshjeve, kontrolli do të kryhet edhe nga inspektoret e trafikut dhe Policia e Kosovës dhe çdo vërejtje që jepet nga këto instucionë do të merren parasysh.
penalet	8.1	Kontraktuesi duhet të intervenoj për largimin e borës pas fillimit te reshurave ku trashësia e bores arrin 3 cm, Kur konstatohen se rrugët janë te pastruara nga bora dhe akulli 24 orë pas ndërprerjes së të reshurave dhe është pengesë përlëvizjen e lirë të qytetarëve dhe automjeteve do të ekzekutohen penalet prej 10€ për çdo km të pa pastruar për çdo ditë sa janë rrugët e pa pastruara.
Obligimet Autoritetit Kontraktues	e 12.3	Menaxheri i Projektit caktohet Burim Kodra, ndersa MDMK Bujar Curri.
Dëmet e likuiduara	13.1	<p>Norma e dëmeve të likuiduara është <b>0.23%</b> në ditë.</p> <p>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontraten është <b>(10% e Çmimit të Kontratës)</b> të çmimit final të kontratës.</p>
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: 10% e vlerës së kontratës apo

			shprehur nominalisht, 4.856.21€, për periudhën kohore 30 muaj.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	(a) (b) (c) (d) (i)	<p>Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsy, përpos irreziqeve të definuar sipas nenit 38 te KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit te kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë;</p> <p>Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</p> <p>Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impanteve, Materialete dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 5.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</p> <p>Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</p> <p>e punëtorëve të Kontraktuesit: 20000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p> <p>a) e personave të tjera: 20000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p>
Parimet përgjithshme pagesës e të	16.1		<p>Orari i pagesës do të jetë: Orari i pagesës do të jetë: Pagesa do të kryhet në fund të sezonit dmth do të kemi vetëm dy pagesa , pagesa e parë do të kryhet në fund te sezonit 2025-2026 , pagesa e dyte në fund të sezonit 2026-2027. Pastrimi i rrugëve të qytetit të Lipjanit sa herë të paraqitet nevoja gjate sezoneve dimërore 2025 - 2026 dhe 2026 - 2027 . Sezoni dimëror fillon 15 nëntor dhe përfundon më 15 prill të vitit vijues. Nëse nuk ka të reshura të borës gjatë kësaj periudhe kohore kontraktuesi është i obliguar që të bëj pastrimin e rrugëve për çdo ditë sikurse që është kontrata për mirëmbajtje të rrugëve gjatë sezonit veror në qytet.</p> <p>Nëse nuk ka të reshura kontraktuesi është i obliguar që të pastrojë rrugët e qytetit të Lipjanit sikurse gjatë zezonit verorë dhe do të paguhet për tërë shumën e kontraktuar.</p>
Kontrolli i kualitetit	17.1		Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: Kontrollimi i shërbimeve do të kryhet nga momenti i fillimit të reshjeve, kontrolla do të kryhet edhe nga inspektoret e trafikut dhe Policia e Kosovës dhe çdo vërejtje që ipet nga këto instacione do të merren parasysh
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2		<b>Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave</b>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1		<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatën Themelore-Prishtinë</b> në</p> <p style="background-color: #ffffcc; padding: 5px;"><b>në pajtim me ligjin në Kosovë</b></p> <p>ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk</p>

		<p>është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin përményrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi</p>
--	--	---

Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve të qytetit për dy sezona dimërore 2025/2026 dhe 2026/2027 - Loti-1							
Aktivitetet							
Poz.	Pershkrimi	Njesia	Sasia	çmimi njësi	Çmimi per 1 (një) herë e hudhjes se kripes per (m <sup>2</sup> )	Sherbimet Sezonale	Shuma per gjithshme për Sezone
1	Largimi I borës nga rrugët dhe trotuareve sipas specifikacioneve të parapara me aktivitete. a) largimi I borës nga rruga,dhe trotuareve b) hudhja e kripës. Vrejtje: me ketë pozicion duhet te jepet qmimi per m <sup>2</sup> për të gjitha rrugët e parapara sipas specifikimeve per mirmbajtjen e një m <sup>2</sup> të rrugës,dhe trotuarit përlagimin e borës dhe hudhjen e krypes- në ditët kur ka të reshura-	m <sup>2</sup>	230,050.00	0.0017	391.09	30.00	11,732.55
	Shuma e përgjithshme tabela -1						
Poz.	Pershkrimi	Njesia	Sasia	çmimi njësi	Shuma		

2	Furnizimi dhe deponimi i krypës me fillimin e sezonit dimërорë,	kg	138,030.00	0.0210	2,898.63
<b>Shuma e përgjithshme tabela 2</b>					<b>2,898.63</b>

	Pershkrimi	njësia	sasia	çmimi per një sezon	Shuma
3	Kompania duhet të caktoj Çmimin për kujdestari gjatë sezonit dimrорë 2023/2025-vlera e këtij pozicioni nuk mundë të jetë më e lartë se 40% e shumës së ofertes,	paushall	1	9,650.00	9,650.00
<b>Shuma e përgjithshme tabela 3</b>					<b>9,650.00</b>

<b>Totali tabela 1+2+3</b>		24,281.18
<b>Totali tabela për dy sezona</b>		48,562.36

Mund të ofertohet deri në 4 numra pas presjes dhjetore

Kontraktuesi është I obliguar në momentin e nënshkrimit të kontratës së paku 1/3 e sasisë së krypës ta ketë të siguruar në depo

Punët e planifikuara

Nr	Pershkrimi i rrugëve	Gjatësi (m')	Gjersi bashkë me trotuar (m')	Sasia e hudhjes se kripes kg/m <sup>2</sup>	Ditë te planifikuara me reshje per hudhje te kripës	Sasia e hudhjes se kripes kg/m <sup>2</sup> per 1 herë	Sasia e hudhjes se kripes kg/m <sup>2</sup> per 30 herë
1	Rr. Skenderbeu	650	11		30	143	4290
2	L. e Prizerenit	400	17		30	136	4080
3	K.Kumanova	400	17		30	136	4080
4	Avdi Kelmendi	1000	17		30	340	10200
5	Xhavit Kozhani	200	8		30	32	960
6	Gjergj Fishta	212	8		30	34	1018

7	Tahir Sinani	260	11		30	57	1716
8	Shen Flori-Albani	300	11		30	66	1980
9	Sadik Shala	1050	10		30	210	6300
10	28 Nëntori	650	4		30	52	1560
11	Zylfije Gashi	400	8		30	64	1920
12	Hamz Jashari	160	9		30	29	864
13	Fehmi Agani	300	9		30	54	1620
14	Shqiperia	215	14		30	60	1806
15	Haradin Bajrami	1000	17		30	340	10200
16	Hamdi Bislimi	1000	8		30	160	4800
17	Fehmi Lladrovci	200	6		30	24	720
18	Qamil Olluri	600	9		30	108	3240
19	Isa Olluri	400	8		30	64	1920
20	Kongresi i Blinajes	300	8		30	48	1440
21	Malet e Sharrit	300	8		30	48	1440
22	Nën Tereza	570	7		30	80	2394
23	Idriz Ajeti	300	8		30	48	1440
24	Ramiz Shala	170	8		30	27	816
25	Qerim Banulla	182	7		30	25	764
26	Haxhi Kleqka	620	12		30	149	4464
27	Grupi Rinor	350	4		30	28	840
28	Millosh Kopiliqi	125	4		30	10	300
29	Aziz Kelmendi	315	4		30	25	756
30	Xhevdet Breznica	250	4		30	20	600
31	Shefki Salihu	1250	6		30	150	4500
32	Jeton Fazliu	170	3		30	10	306
33	24 Marsi	220	4		30	18	528
34	Mihajl Pupin	125	4		30	10	300
35	Halil Meta	300	4		30	24	720
36	12 Qershori	450	6		30	54	1620
37	2 Korriku	300	4		30	24	720
38	Shaqir Hoxha	300	5		30	30	900
39	Mbretresha Teut	300	5		30	30	900

40	Lulzim Llugiqi	50	4		30	4	120
41	Bashkim Krasniqi	750	8		30	120	3600
42	Martiret e Lipjanit	350	6		30	42	1260
43	Ulpiana	125	4		30	10	300
44	Enver Olluri	200	5		30	20	600
45	Iliria	130	4		30	10	312
46	Ibrahim Krasniqi	120	4		30	10	288
47	Mbreti Agron	250	5		30	25	750
48	Bejtush Gerbeshi	1050	8		30	168	5040
49	Avdi Avdiu	100	4		30	8	240
50	Vezir Kolshi	100	4		30	8	240
51	Miftar Sopi	100	4		30	8	240
52	Bajram Curri	150	4		30	12	360
53	Isa Dema	200	4		30	16	480
54	Muzaqete Begolli	100	4		30	8	240
55	I-Maji	120	4		30	10	288
56	Mbreti Zog	120	6		30	14	432
57	Pjeter Bogdani	50	4		30	4	120
58	Martiret e Akllapit	430	5		30	43	1290
59	Ali Hadri	170	4		30	14	408
60	Afrim Zhitija	200	5		30	20	600
61	Sami Frasherri	100	5		30	10	300
62	Konjuhi	3500	7		30	490	14700
63	Rr. Marie Shllaku	2000	8		30	320	9600
63	Rr e tranzitit -Bajram Gashi-Sadik Shala	1500	8		30	240	7200
	<b>TOTALI</b>	<b>28,259</b>				<b>4601</b>	<b>138030</b>

<b>Kapaciteti profesional</b>			
1	Projektmenaxheri: Inxhinjer barchlor I ndertimtarisë apo i komunikacionit me tri vjet pervoje pune		1
2	Puntor fizik		6

Mjetet e punës		Njësia	Sasia
1	Kamion me mekanizem per largimin e bores (pllugun) me hedhes te kripës	copë	2
2	Ngarkues i madhë (Lugë) si dhe makinë gryese e shtreses së akullit ( Greder ) nese paraqitet nevoja per heqjen e shtreses së akullit ne rruge	copë	1



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPSHTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë: 04.08.2025

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, rregullorës për prokurim publik NR; 001/2022, dhe udhëzuesi nxjerrë:


#### V E N D I M

1.1 Caktohet Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësit i realizimit të kontratës për kontratën me titullin: **Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror 6 Llote** me numër identifikues: **613-25-5004-2-1-1, Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror** në qytetin e Lipjanit, llojet,

1. **Burim Kodra**, Drejtoria për Shërbime Publike, caktohet menaxher i kontratës.
2. Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë për realizimin e kontratës sipas pikës 1 dhe të këtij vendimi caktohet:
  - a) **Bujar Curri**, Drejtoria për Inspektoriat.
3. Menaxheri i kontratës, obligohet qe të hartoj një Plan të te Menaxhimit te Kontratës, duke përdorur formularin Standard te miratuar nga KRPP, i cili duhet të nënshkruhet nga ana e te dy palëve (Menaxherit te kontratës se AK dhe Menaxherit te Kontratës se OE) para inicimit të zbatimit të kontratës dhe një kopje të nënshkruar te planit për menaxhimin e kontratës do ta përcjelle tek departamenti i prokurimit.
4. Menaxheri i kontratës e menaxhon kontratën deri në pranimin e plotë të [artikujve/shërbime/punëve] të kërkuar respektivisht deri në përmbylljen e kontratës.
5. Përgjegjësitetë dhe funksionet e Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejt për menaxhim te kontratës janë:
  - a) Monitorimin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, dhe
  - b) Rishikimin, aprosimin dhe procesimin e vlerësimit të përformancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuar nga menaxherët e kontratave nën mbikqyrjen e tij.
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Kopje:** Menaxhereve të projektit;  
Mbikëqyrësit të MDMK-së.  
Departamentit te Prokurimit;

Zyrtari Kryesor Administrativ  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPSHTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë: 04.09.2025

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, rregullorës për prokurim publik NR; 001/2022, dhe udhëzuesi nxjerrë:

**V E N D I M**

Caktohet Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësit i realizimit të kontratës për kontratën me titullin: **Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimër 6 Llote** me numër identifikues: 613-25-5004-2-1-1, Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimër pjesa përendimore 2, llot 4

1. Besart Zejnullahu, Drejtoria për Shërbime Publike, caktohet menaxher i kontratës.
2. Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë për realizimin e kontratës sipas pikës 1 dhe të këtij vendimi caktohet:
  - a) Enver Elshani, Drejtoria për Shërbime Publike.
3. Menaxheri i kontratës, obligohet qe të hartoj një Plan të te Menaxhimit te Kontratës, duke përdorur formularin Standard te miratuar nga KRPP, i cili duhet të nënshkruhet nga ana e te dy palëve (Menaxherit te kontratës se AK dhe Menaxherit te Kontratës se OE) para inicimit të zbatimit të kontratës dhe një kopje të nënshkruar te planit për menaxhimin e kontratës do ta përcjelle tek departamenti i prokurimit.
4. Menaxheri i kontratës e menaxhon kontratën deri në pranimin e plotë të [artikujve/shërbime/punjëve] të kërkuar respektivisht deri në përbylljen e kontratës.
5. Përgjegjësitë dhe funksionet e Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejt për menaxhim te kontratës janë:
  - a) Monitorimin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, dhe
  - b) Rishikimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të përfomancës së kontraktuesit – vlerësimi të propozuar nga menaxherët e kontratave nën mbikqyrjen e tij.
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Zyrtari Kryesor Administrativ  
Imri Ahmeti

Kopje: Menaxhere të projektit;  
Mbikëqyrësit të MDMK-së.  
Departamentit te Prokurimit;



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPSHTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë: 04.09.2025


Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, rregullorës për prokurim publik NR; 001/2022, dhe udhëzuesi nxjerrë:

#### V E N D I M

Caktohet Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësit i realizimit të kontratës për kontratën me titullin: **Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimër 6 Llote me numër identifikues: 613-25-5004-2-1-1, Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimër 6 Kleqk[ dhe Divjak, llot6,**

1. **Besart Zejnullahu**, Drejtoria për Shërbime Publike, caktohet menaxher i kontratës.
2. Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë për realizimin e kontratës sipas pikës 1 dhe të këtij vendimi caktohet:
  - a) **Enver Elshani**, Drejtoria për Shërbime Publike.
3. Menaxheri i kontratës, obligohet qe të hartoj një Plan të te Menaxhimit te Kontratës, duke përdorur formularin Standard te miratuar nga KRPP, i cili duhet të nënshkruhet nga ana e te dy palëve (Menaxherit te kontratës se AK dhe Menaxherit te Kontratës se OE) para inicimit të zbatimit të kontratës dhe një kopje të nënshkruar te planit për menaxhimin e kontratës do ta përcjelle tek departamenti i prokurimit.
4. Menaxheri i kontratës e menaxhon kontratën deri në pranimin e plotë të [artikujve/shërbime/punjëve] të kërkuar respektivisht deri në përmbylljen e kontratës.
5. **Përgjegjësitë dhe funksionet e Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejt për menaxhim te kontratës janë:**
  - a) Monitorimin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, dhe
  - b) Rishikimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të përformancës së kontraktuesit – vlerësimë të propozuar nga menaxherët e kontratave nën mbikqyrjen e tij.
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Zyrtari Kryesor Administrativ  
Imri Ahmeti



**Kopje:** Menaxhere të projektit;  
Mbikëqyrësit të MDMK-së.  
Departamentit te Prokurimit;



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPSHTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë: 04.09.2025

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, rregullorës për prokurim publik NR; 001/2022, dhe udhëzuesi nxjerrë:

**V E N D I M**

1.1 Caktohet Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësit i realizimit të kontratës për kontratën me titullin: **Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror 6 Lloje** me numër identifikues: **613-25-5004-2-1-1**, **Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror pjesa lindore 1, llot 2**,

1. **Burim Kodra**, Drejtoria për Shërbime Publike, caktohet menaxher i kontratës.
2. Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë për realizimin e kontratës sipas pikës 1 dhe të këtij vendimi caktohet:
  - a) **Bujar Curri**, Drejtoria për Inspektoriat.
3. Menaxheri i kontratës, obligohet qe të hartoj një Plan të te Menaxhimit te Kontratës, duke përdorur formularin Standard te miratuar nga KRPP, i cili duhet të nënshkruhet nga ana e te dy palëve (Menaxherit te kontratës se AK dhe Menaxherit te Kontratës se OE) para inicimit të zbatimit të kontratës dhe një kopje të nënshkruar te planit për menaxhimin e kontratës do ta përcjelle tek departamenti i prokurimit.
4. Menaxheri i kontratës e menaxhon kontratën deri në pranimin e plotë të [artikujve/shërbime/punëve] të kërkuar respektivisht deri në përmbylljen e kontratës.
5. Përgjegjësitetë dhe funksionet e Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejt për menaxhim te kontratës janë:
  - a) Monitorimin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, dhe
  - b) Rishikimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të përformancës së kontraktuesit – vlerësimë të propozuar nga menaxherët e kontratave nën mbikqyrjen e tij.
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Zyrtari Kryesor Administrativ  
Imri Ahmeti

**Kopje:** Menaxhereve të projektit;  
Mbikëqyrësit të MDMK-së.  
Departamentit te Prokurimit;



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPSHTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë: 04.09.2025


Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, rregullorës për prokurim publik NR; 001/2022, dhe udhëzuesi nxjerrë:

**V E N D I M**

Caktohet Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësit i realizimit të kontratës për kontratën me titullin: **Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimër 6 Llote** me numër identifikues: 613-25-5004-2-1-1, **Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimër 2, lloji 3**

1. **Burim Kodra**, Drejtoria për Shërbime Publike, caktohet menaxher i kontratës.
2. Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë për realizimin e kontratës sipas pikës 1 dhe të këtij vendimi caktohet:
  - a) **Bujar Curri**, Drejtoria për Inspektoriat.
3. Menaxheri i kontratës, obligohet qe të hartoj një Plan të te Menaxhimit te Kontratës, duke përdorur formularin Standard te miratuar nga KRPP, i cili duhet të nënshkruhet nga ana e te dy palëve (Menaxherit te kontratës se AK dhe Menaxherit te Kontratës se OE) para inicimit të zbatimit të kontratës dhe një kopje të nënshkruar te planit për menaxhimin e kontratës do ta përcjelle tek departamenti i prokurimit.
4. Menaxheri i kontratës e menaxhon kontratën deri në pranimin e plotë të [artikujve/shërbime/punëve] të kërkuar respektivisht deri në përmbylljen e kontratës.
5. Përgjegjësitet e funksionet e Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejt për menaxhim te kontratës janë:
  - a) Monitorimin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, dhe
  - b) Rishikimin, aprosimin dhe procesimin e vlerësimit të përformancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuar nga menaxherët e kontratave nën mbikqyrjen e tij.
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Zyrtari Kryesor Administrativ  
Imri Ahmeti



**Kopje:** Menaxhere të projektit;  
Mbikëqyrësit të MDMK-së.  
Departamentit te Prokurimit;

## KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN

# NJOFTIM PËR KONTRATË

**PUNË**

**FURNIZIM**

**SHËRBIME**

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

**Data e përgatitjes së njoftimit: 05.06.2025**

Nr i Prokurimit	613-25-5004-2-1-1
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



## NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

### I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN		
Adresa Postare: SHQIPERIA		
Qyteti: LIPJAN	Kodi postar: 14000	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Bekim Shabani		Telefoni: +383 2041539
Email: bekim.g.shabani@rks-gov.net		Faksi:
Adresa e Internetit (nëse aplikohet):		

Po  Jo

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po  Jo

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

*Nëse po*, specifiko identitetin e të gjithë Autoritetave Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

## NENI II: LËNDA E KONTRATËS

## II.1) PËRSHKRIMI

### II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:

Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimërор 6 Llote

### II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit

(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

<input type="checkbox"/> Punë	<input type="checkbox"/> Furnizime	<input checked="" type="checkbox"/> Shërbime
<input type="checkbox"/> Ekzekutim <input type="checkbox"/> Plani dhe ekzekutimi <input type="checkbox"/> Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	<input type="checkbox"/> Blerja <input type="checkbox"/> Qira financiare (lizing) <input type="checkbox"/> Qira <input type="checkbox"/> Blerje me këste <input type="checkbox"/> Një kombinim i këtyre	

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit

Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuarëve gjatë sezonit dimërор 5 llore Llot 1 Zona Urbane Qyteti i Lipjanit;Llot 2 Zona Lindore 1 Fshati Kojiske, Rubofc i Vogel, Rubofc i Madh, Llugaxhi, Gumnaselle, Banulle, Glogovc, Sllovije, Terbuvc, Smallushe, Qallapek, Gadime e Ulet, Gadime e Eperme, Babush i Muhaxhereve, Vrelle e Gadimes, Vrelle Plitkovic, Marevc, Gllavice, Smallushe, Shtigjet e ecjes Gadime; Llot 3 Zona Lindore 2, Gushterice e nalt-Akllap, Akllap - Sllovi, Rrua nga Metallaci - Janjeve me rrugët dytësorë, Teqe, Brus;Llot 4 Zona Perendimore Lipjan-Hallaq i Madh, Kraishte, Ribar i Madh, Zllakuqan, Magure, Pojata Krojmiri II, Medvec, Harilaq i vogel, Vrelle e Magures, Qylage, Bminaj, Dobrave e Madhe, Gllanice, Gllanice-Torine, Lluga, Dobrave e vogel-Medvec, Poturovc, Torine, Ribar i vogel, Ribar i vogel-Torine, Rufc i Ri - Hallaq i Madh, Rufc i Ri, Rufc i Vjeter, Hallaq i Vogel, Gracke e Vjeter, Jeta e Re, Topliqan, Topliqan-Gracke e Vogel, Gracke e Vogel, Bujan, Bregu i zi, Varigovc, Bregu i Zi;Llot 5 Pjesa Perendimore 2 Leletiq, Mirene, Shale, Shale-Baince, Resinovc, Baince, Krojmir, Pojate-Krojmir II, Kleqke, Divjake

### II.1.3) Njoftimi përfshinë

Krijimin e kontratës publike kornizë



